REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 744/20
Datë/Datum. 23.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Hysi Muhadri eks. Shqyrtues Mentor Shala eks.Teknik	***Data e autorizimit të ekspertit*** ***14.10.2020***	***Data e dorëzimit të raportit*** ***23.10.2020***	***Nr. i lëndës:*** ***744/20***

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 30.09.2020, OE **"CRAZY PET SH.P.K.DR.BUB NJESIA NR.1"**, ka parashtruar ankesë me nr: **744/20,** kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE " Samire Osmani B.I.'' lidhur me aktivitetin e prokurimit: ***"Furnizim me pajisje mbrojtese Anti Covid 19",*** me nr. të prokurimit***:*** **102-20-4380-1-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- ZYRA E PRESIDENTIT TE REPUBLIKES SE KOSOVES

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës kontrat publike korniz –Funizim vlera e parashikuar e kontratës **30 500,00** €

Data e njoftimit për kontratë 13.08.2020,
Data e hapjes së ofertës 03.09.2020.
Data e njoftimit AK-së 14.09.2020.
Data e kërkesës për rishqyrtim 18.09.2020.
Data e vendimit mbi refuzim të kërkesës për rishqyrtim 21.09.2020.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-

068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2. PRETENDIMET ANKIMORE

OE ankus pretendon se AK, nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-se, siç janë:
Neni 1, 6, 7, 27, 28, 52, 56.3, 59, 72, 108 A, të LPP-së

DEKLARATA DETALE E ANKESES

Kunder vendimit te AK per eliminimin tone nga ky aktivitet i prokurimit dhe kunder vendimit mbi dhenien e kontrates OE te pa pergjegjshem ne pajtim me dispozitat e nenit 108A kemi parashtruar kerkese per ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit: 102 – 20 – 4380 – 1 – 2 – 1, nr i brendshem ZPRK – 102 – 021 - 121.

AK me rastin e ri – shqyrtimit te kerkeses tone nuk ka vepruar konform dispozitave te LPP dhe fare nuk ka trajtuar oferten tone se jemi te pergjegjshem apo jo, poashtu e njejta ashtu siq ka vendosur me rastin e vleresim ka konstatuar dhe ka konfirmuar shkeljet te cilat i ka bere gjate vlersimit te ofertave ashtuqe duke vepruar ne kundershtim me dispozitat e nenit 108A e lene ne fuqi vendimin per dhenie te kontrates.

Bazuar ne vendimin e AK gjejme se me rastin e zhvillimit te ketij aktiviteti te prokurimit e ne veqanti me rastin e vleresimit, ekzaminimit dhe krahasimit te tendereve por edhe me rastin e ri – shqyrtimit ka bere:

- **Shkelje esenciale te dispozitave te LPP –se dhe**
- **Vertetim te gabuar te gjendjese faktike.**

Se AK – Zyra e Presidentit te Republikes se Kosoves ka bere vertetim te gabuar te gjendjes faktike kjo eshte evidente gjate vleresimit dhe ri – shqyrtimit te ofertave e sepse nuk ka vepruar konform nenit 27, 28 dhe 59 LPP duke rekomanduar per kontrate OE ''Samire Osmani B.I.'' i cili OE nuk ka plotesuar kerkesat e DT sipas Aneksi 1 per Llot 2, eshte kerkuar qe: ''Dezinfektimi te jete aktiv sipas rregullave te BE: 528/2012, te jete aktiv kunder: viruseve, baktereve, majave, dhe kepurdhave,

Alkydimethylbenzylammoniumchloride (CAS 68424/85/1).

Didecyldimethylammoniumchloride (CAS 7173/51/5),

Glutaraldeyde (CAS 111/30/8)

Ekipi dezinfektues duhet te jete ne gjendje qe te pergjigjet ne kerkessat tona ne qdo kohe pa paralajmerim.

Nga shkresat e lende ne oferten e OE te rekomanduar per kontrat gjate qasjes ne ofeten e tij kemi gjetur se Certifikata e dorezuar/data sheet te prodhuesit Ing.G.Linker ne dosjen e tenderit i mungojne perbersit sipas

specifikimit teknik te detyruar dhe ate sipas Aneksit 1 te DT.

Po ashtu nga dokumentacioni i ofruar nuk kemi gjetur se ka nje deklarat me te cilin ploteson kerkesen e AK lidhur: **''Ekipin dezinfektues qe duhet te jete ne gjendje qe te pergjigjet ne kerkesat tona ne qdo kohe pa paralajmerim''.**

AK edhe perkunder vrejtjeve tona gjate kerkeses per ri-shqyrtim nuk ka marr veprime per te eliminuar gabimet te bera ne fazen e vleresimit. Arsyetimi i tyre ne vendimin mbi refuzimin e kerkeses per ri-shqyrtim eshte ne kundershtim me nenin 7,56, 3 dhe 59 te LPP sepse eshte shume e qarte kerkesa e AK ne Aneksin 1 ku vete AK e konfirmon se OE ka shperehe gadishmerin te ofroj edhe produktin **Glutaraldehyde (CAS 111/30/8)** qe konfirmohet pretendimi jone se i njejti nuk ka permbush specifikimet teknike te detyrueshme.

Po ashtu edhe vete prodhuesi me te cilin OE ''Samire Osmani B.I.'' ka ofertuar e pranon se nuk kan kete produkt por mund te ofrojne nje produkt tjeter qe e zevendson ate te kerkuar ne DT.

Nga shiqimi i ofertave te OE tjere pjesemarres gjejme se te ntit nuk kan plotesuar kerkesat e DT dhe njoftimit per kontrate ashtu siq eshte gjetur ne raportin e komisionit vleresues.

AK gjate ri-shqyrtimit dhe vleresimit vrehet qarte se ka bere nje mal me shkelje te dispozitave te LPP dhe ate:

Bazuar ne te cekurat me larte gjejme se AK me rastin e ri-vlersimit te ketij aktiviteti te prokurimit ka vepruar ne kundershtim me dispozitat e nenit 7 te LPP Barazia ne trajtim/jo diskriminim citat i nenit 7.1 ''Autoriteti kontraktues do ti trajtoj OE ne menyre te barabarte dhe jo diskriminuese dhe do te veproje ne menyre jo diskriminuese''.

AK me eliminimin tone si OE te cilit kemi pas oferten tone me qmim me te ulet ka vepruar ne kundershtim me nenin 1 te LPP citat i nenit 1.1 te LPP-se:

''1. Qellimi i ketij ligji eshte te siguroj menyren me efikase, me transparente dhe me te drejte te shfrytezimit te fondeve publike, burimeve publike si dhe te gjitha fondeve dhe burimeve te trjera te autoriteteve kontraktuese ne Kosove duke percaktuar kushtet dhe rregullat qe do te zbatohen, procedurat qe do te ndiqen, te drejtat qe do te respektohen dhe detyrimet qe do te permbushen nga personat, operatoret ekonomik, ndermarrjet, autorietet kontraktuese, koncesioneret e puneve dhe organet publike qe zhvillojne, perfshihen, marrin pjese ose interesohen, ne aktivitetet e prokurimit ose qe perfshihen ose kane te bejne me fondet dhe/ose burimet e tilla''.

Po ashtu edhe neni 6 i LPP-se i obligon AK te sigurojne fondet publike dhe burimet publike te perdoren ne menyre ekonomike citat i nenit 6 te LPP-se:

''Te gjitha autoritetet kontraktuese, jane te obliguara qe te sigurojne qe fondet publike dhe burimet publike te

perdoren ne menyren me ekonomike, njekohesisht duke marre ne konsiderate qellimin dhe lenden e prokurimt.

2. Fondet publike dhe burimet publike qe jane ofruar ose qe jane vene ne dispozicion sipas nje kontrate publike mund te perdoren vetem nga kontrata e tille dhe vetem per qellimet e te njejtes.

AK me rastin e vlersimit dhe tri vlersimit ka ra ndesh me enin 27 dhe 28 te LPP sepse ka rekomanduar per kontrate OE i cili nuk ka plotesuar sepcifikat teknike te detyrueshme.

AK nuk ka bere versimin, ekzaminimin dhe krahasimin e ofertave konform nenit 59.4 te LPP.

Paragrafi 4 i nenit 59 te ketij ligji, percakton, citojme:

''4. Autoriteti kontraktues do te konsideroje nje tender si te pergjegjshem vetem nese tenderi ne fjale eshte ne perputhshmeri me te gjitha kerkesat e parashtruara ne njoftimin e kontrates dhe ne dosjen e tenderit pavaresisht nga e meparshmja, autoriteti kontraktues mund te konsideroje nje tender si te pergjegjshem nese: (i)permban vetem gabime ose paqartesi te cilat mund te korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjale, ose (ii) permban vetem devijime te vogla qe nuk mund te shkaktojne ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kerkesat e tjera te parashtruara ne njoftimin e kontrates dhe ne dosjen e tenderit; me kusht qe, qfaredo devijimi i tille te kuantifikohet, aq sa eshte e mundshme, dhe te merret parasysh gjate vleresimit dhe krahasimit te tendereve''.

Po ashtu edhe dispozitat neni 56.3 e artesojne kete qeshtje sepse nuk mund te vlersohet te eliminohet apo rekomandohet nje OE per kontrat per nje kerkes, kriter apo specifikim i cili nuk ka qene kerkese e DT dhe njoftimit per kontrate citat i kesaj dispozite:

''3. Tenderuesi, gjate procedurave te hapura, ose kandidati, gjate procedurave te kufizuara dhe procedurave te negociuara, pas publikimit te njoftimit te kontrates, nuk do te diskualifikohet ose perjashtohen nga procedurat e tilla ne baza te ndonje kerkese ose kriteri qe nuk eshte i cekur ne njoftimin e kontrates dhe ne dosjen e tenderit.''

AK ka pas detyrim e ne kuptim te nenit 108A me rastin e ri – shqyrtimit te evitoj gabimet e komisionit vlersues sepse OE nuk ka plotesuar kerkesat e DT dhe NJPK.

Andaj bazuar ne te gjeturat e cekura me larte Paneli shqyrtues i OSHP me rastin e shqyrtimit te kesaj ankese lidhur me aktiviteti i prokurimit: ''Furnizim me pajisje mbrojtese Anti Covid – 19''.nr. i Aktivitetit te prokurimit: 102-20-4380-1-2-1, nr i brendshem ZPRK-102-021-121 te merr kete:

VENDIM

1. Aprovohet si e bazuar ankesa e OE: CRAZY PET SH.P.K. DR. BUBA NJESIA NR.1 lidhur me

aktivitetin e prokurimit: ''Furnizim me pajisje mbrojtese Anti Covid-19''.nr.i Aktivitetit te prokurimit: 102-20-4380-1-2-1, nr i brendshem ZPRK-102-021-121.

2. Anulohet njoftimi per dhenie te kontroates lidhur me aktivitetin e prokurimit: ''Furnizim me pajizje mbrojtese Anti Covid – 19''.nr. i Aktivitetit te prokurimit: 102-20-4380-1-2-1,nr i brendshem ZPRK – 102-021-121 dhe lenda kthehet ne ri-vleresim.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

		Kërkesat e përshtatshmërisë: **Kërkesa numër 1** **Deklarata nën betim se operatori ekonomik i përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë sipas LPP nr. 04 L-042, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092.** **Kërkesa numër 2** **Vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit -vetëm për fituesin.** **Kërkesa numër 3** **Vërtetimin nga Gjykata- Një dokument te lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e përshtatshmërisë"- te jete i lëshuar se paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit, origjinal kopje e noterizuar - vetëm për fituesin.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Dëshmitë për kërkesën nr.1** **Deklaratë nën betim – Origjinali.** **Dëshmitë për kërkesën nr.2 Një vërtetim nga Administrata Tatimore - vetëm për fituesin.** **Dëshmitë për kërkesën nr.3** **Vërtetimin nga Gjykata - origjinal ose kopje e noterizuar- vetëm për fituesin**
Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	**Përshtatshmëria profesionale** **Kërkesa numër 1**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Dëshmitë për kërkesën nr.1**

		Regjistrimin si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në shtetin e themelimit të operatorit ekonomik me numër fiskal. Kërkesa numër 2 Operatori ekonomik duhet të ketë certifikatë të TVSH-së. Kërkesa numër 3 Operatori ekonmik duhet të jetë i certifikuar ose të ketë leje për kryerjen e shërbimeve të DDD-së (Dezinfektim, Dezinsektim dhe Deratizim) nga Ministria përkatëse, ose të ketë marrëveshje me një operator ekonomik të certifikuar për DDD për ofrimin e këtyre shërbimeve.	**Certifikatë e regjistrimit të biznesit me numër fiskal – kopje. Dëshmitë për kërkesën nr.2 Certifikatë të TVSH-së. - kopje Dëshmitë për kërkesën nr.2 Certifikatë ose leje për kryerjen e shërbimeve të DDD në emër të OE pjesëmarrës në tender Ose Marrëveshja e OE pjesëmarrës në tender (e nënshkruar dhe e vulosur) me një operator ekonomik i cili është i certifikuar për ofrimin e shërbimeve**
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	**Kapaciteti ekonomik dhe financiar**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Nr. i pjesës	Emërtimi i grupit	Përshkrimi i shkurtër	FPP	Sasia apo fushëveprimi	Informacio ne shtesë
Grupi 1.	**Furnizim me pajisje mbrojtëse Anti Covid 19**	**Furnizim me pajisje mbrojtëse Anti Covid 19**	**93000000-8**	**1. Furnizim me maska mbrojtëse kirurgjikale një përdorimshe 500 kuti 2. Dezinfektues antiseptic dermatologjikisht I pranuar me përberje 100ml të përmbajne se paku 75 gr propan , dexpanthenol, ethylexlglycerin, pa ngjyre plus**	

				panthenol te listuara nga IHO dhe qertifikuar nga VAH 500 cope	
Grupi 2.	Shërbime te dezinfektimit	Shërbime të dezinfektimit	93000000-8	Shërbime të dezinfektimit 1200 m2	

Dezinfektimi të jetë aktiv sipas rregullave te BE: 528/2012
Të jete aktiv kunder viruseve, baktereve, majave dhe kërpudhave
Alkydimethylbenzylammoniumchloride (CAS 68424/85/1)
Didecyldimethylammoniumchloride (Cas 7173/51/5)
Glutaraldehyde (Cas 111/30/8)
Ekipi dezinfektues duhet të jetë në gjendje që të përgjigjet në kërkesat tona në cdo kohë pa paralajmerim

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Oferta e pergjegjeshme me cmimin me te ulet per furnizim eshte ''Matkos Pharm'' e cila sipas komisionit i ploteson kushtet per kontraktim, ndersa per sherbim tenderi i pergjegjshem me cmim me te ulet i cili rekomandohet per kontrate eshte Samire Osmani Biznes Individual.

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

NA

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Sqarim hyrës: ZYRA E PRESIDENTIT TE REPUBLIKES SE KOSOVES gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës kontratë publike kornizë - Funizim. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës. Kundër të njëjtit propozim parashtruesi i ankesës ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim tek AK, sipas afateve të parapara me LPP. AK përmes vendimit ka refuzuar kërkesën si të pa bazuar.

Përgjigje në pretendimet ankimore te OE "CRAZY PET SH.P.K.DR.BUB NJESIA NR.1"

Lidhur me pretendimin e OE ankues "CRAZY PET SH.P.K.DR.BUB NJESIA NR.1", ku: OE i rekomanduar per kontrate ''Samire Osmani B.I.'' nuk ka plotesuar kerkesat e DT sipas Aneksit 1., ku eshte kerkuar qe

dezinfektimi te jete aktiv sipas rregullave te BE: 528/2012, te jete aktiv kunder viruseve, majave dhe kepurdhave,

Alkydimethylbenzylammoniumchloride (CAS 68424/85/1).

Didecyldimethylammoniumchloride (CAS 7173/51/5),

Glutaraldeyde (CAS 111/30/8)

Ekipi dezinfektues duhet te jete ne gjendje qe te pergjigjet ne kerkessat tona ne qdo kohe pa paralajmerim.

Sipas OE ankues, OE i rekomanduar per kontrate i mungojne perbersit sipas specifikimit teknik te detyruar dhe ate Glutaraldehyde (CAS 111/30/8), me cka ky OE nuk ka plotesuar kete kerkese te detyrueshme sipas Aneksit 1 te DT.

Eksperti shqyrtues/teknik ka shiqur me shume kujdese kerkesat ne DT dhe pretendimin ankimor te OE ankues dhe vie ne perfundim qe OE te rekomanduar per kontrat i mungon perbersi (nuk ka ofruar) GLUTARALDEHYDE (CAS 111/30/8), ashtu siq kerkohet ne Aneksin1. Specifikimet teknike te detyrueshme. Kete e pranon edhe AK permes Vendimit per refuzim te kerkeses per rishqyrtim te OE Crazy Pet Sh.P.K.Dr. Buba .

Eshte e vertete qe GLUTARALDEHYDE 4.9 perdoret per dezinfektimin e shtallave te kafsheve dhe poashtu Diemersept – 10 eshte nje produkt/dezinfektues shume i mire i cili perdoret ne Spitale dhe Klinika mjeksore, mirëpo nuk është asnjë njoftim ose përgjigje nga AK, se mund të ofertohet edhe me ndonjë produkt tjetër që nuk është konform specifikave teknike te detyrueshme ne Aneksin1 të DT.

Eksperti shqyrtues/teknik e kualifikon si te bazuar kete pretendim ankimor te OE ankues "CRAZY PET SH.P.K.DR.BUB NJESIA NR.1".

Sa i perket pretendimit ankimor te OE ankues, ku: Po ashtu nga dokumentacioni i ofruar nuk kemi gjetur se ka nje deklarate me te cilin ploteson kerkesen e AK lidhur me: ''Ekipi dezinfektues qe duhet te jete ne gjendje qe te pergjigjet ne kerkesat tona ne cdo kohe pa paralajmerim''.

Eksperti shqyrtues/teknik sqaron se ne Aneksin1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TE DETYRUESHME kerkohet qe: ''Ekipi dezinfektues qe duhet te jete ne gjendje qe te pergjigjet ne kerkesat tona ne cdo kohe pa paralajmerim'', por jo edhe nje dekalarate e tille siq ceket nga OE ankues.

Eksperti shqyrtues/teknik e kualifikon si te pa bazuar kete pretendim ankimor te OE ankues.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të merret si pjesërisht e pabazuara, dhe lënda të kthehet në rivlerësim .

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - ZYRA E PRESIDENTIT TE REPUBLIKES SE KOSOVES
- Panelit Shqyrtues - OSHP.
- OE ankues - OE "CRAZY PET SH.P.K.DR.BUB NJESIA NR.1"